

**STATUTI I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“CRYPTO WORLD”SH.P.K.**

**NENI 1  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

1. Në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, sot me dt. 08/07/2021, me vullnet të lirë, ortaku i vetwm:

**Z. Marin Gjonaj**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 30.08.1985, banues në Tiranë, Rruga “Sami Frashëri”, Shkalla D, Ap. 2/3, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër personal I50830192B

vendosi tw themelojw kwtw shoqwri sipas kushteve tw pwrcaaktuara nw kwtw statut me pwrmbajtjen si vijon:

**NENI 2  
EMRI**

1. Emri i shoqërisë është “**CRYPTO WORLD**” SHPK.

**NENI 3  
FORMA**

1. Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara për kapitalin.

**NENI 4  
SELIA**

1. Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Ndertesa Park Gate, rruga e Elbasanit, kati i 1-re, Tirane, Shqiperi
2. Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5  
AFATI**

1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i pakufizuar. Afati mund të kufizohet, mund të zgjatet apo shkurtohet një ose disa herë vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



## **NENI 6 OBJEKTI**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

“Kryerje te procesit te mining te cryptomonedhave per te krijuar asete crypto per shoqerine. Blerje dhe shitje me shumice te pajisjeve te ndryshme elektronike perfshire ato qe perdoren per cryptocurrency mining. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjise elektrike nga burime hidro, gaz natyror, qymyr si dhe nga burime alternative si parqet e erez, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasat etj. Cdo aktivitet tjeter tregtar qe lidhet ne menyre te drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Sipas legjislacionit ne fuqi, shoqeria ne menyre qe te arrije objektivat e saj mund te kryeje aktivite te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise. Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.”

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitetë të tjera shtese, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë së saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **NENI 7 KAPITALI**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është njëqind (100.00) Lekë, i perbere nga nje (1) kuote e zotëruar plotësisht nga ortakut i vetwm Z. Marin Gjonaj.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesës së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

## **NENI 8 MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Ortakët mund t’u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t’ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte të njëjta nga ato që do ju ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e marrjes së komunikimit, në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.
3. Secili prej ortakëve mund të tjetërsojë kuotën e tij nëpërmjet veprimit juridik të dhurimit



tek subjekte/persona të tretë të cilët nuk kanë lidhje familjare me ortakun (bashkëshorti/ja, fëmijët, vëllezërit dhe motrat) ose tek ndonjëri prej ortakëve të tjerë, vetëm me miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

4. Ortaku i cili vendos të tjetërsojë kuotën e tij nëpërmjet veprimit juridik të shitjes tek ortakët e tjerë, kuota do të përfitohet nga ortaku që ofron çmimin më të lartë të blerjes. Për këtë qëllim ortaku që kërkon të shesë kuotën, njofton ortakët e tjerë për të paraqitur propozimet e tyre për blerjen e saj brenda brenda (30) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.
5. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit).
6. Kuotat janë të papjesëtueshme. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

## **NENI 9 ORGANET E SHOQËRISË**

1. Organet drejtuese të shoqërisë janë :
  - Asambleja e përgjithshme;
  - Administratori.
2. Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

## **NENI 10 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME KOMPETENCAT**

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

## **NENI 11 MBLEDHJA E ASAMBLESE**



1. Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarët” i ndryshuar. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

## NENI 12 THIRRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shprehje të komunikuar në adresat e postës elektronike të përcaktuara në pjesën identifikuese të të dhënave të ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
3. Mbledhja e Asamblesë mund të mbahet sipas rastit në selinë e shoqërisë ose nëpërmjet pjesëmarrjes së ortakëve me video konferencë.
4. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.
5. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
6. Asambleja e përgjithshme vendos me 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për:
  - a. ndryshimet e statutit;
  - b. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - c. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - d. shpërndarjen e fitimeve;
  - e. për kryerjen e investimeve/realizimin e sipërmarrjeve/projekteve të cilat kanë një vlerë me të madhe se EUR 5,000,000 (pesë milion euro);
  - f. raste të tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti.
7. Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë (50% +1 të votave) të ortakëve pjesëmarrës për raste të tjera si më poshtë:
  - a. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - b. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - c. përcaktimin e shpërblimeve për administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.



- d. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e. përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statut.

### **NENI 13**

#### **PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ASAMBLESË**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
2. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

### **NENI 14**

#### **HETIMET E POSAÇME**

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë (5) për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda tridhjetë (30) ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
3. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, duhet të ushtrohet brenda tre (3) viteve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda tre (3) viteve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

### **NENI 15**

#### **ORGANI ADMINISTRATIV**

1. Shoqëria do të administrohet nga një Administrator i cili emërohet për një mandat 5 – vjeçar me të drejtë riemërimi.
2. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.



3. Administratori do të përfitojë një shpërblim të miratuar nga ortakët, do të ketë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të kryera për arsye pune, si dhe do të përfitojë një shpërblim në rastin kur largohet nga detyra.
4. Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për punë të veçanta apo grup punësh dhe ti revokojë ata, mund të emërojë drejtorë, zv. drejtorë dhe agjentë, mund të ndër marrë dhe përballet me çështje gjyqësore në çdo shkallë gjyqësore duke emëruar avokatë, përfaqësues dhe ekspertë dhe duke i revokuar ata.
5. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Ermand Hysi**.

## **NENI 16 KOMPETENCAT**

1. Administratori ka këto kompetenca:
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - e) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
2. Administratori është kompetent edhe për të:
  - realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
  - propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
  - marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
  - propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## **NENI 17 SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

## **NENI 18 KUFIZIMI I SHPËRNDARJEVE TË FITIMEVE**



1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - a. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme.
2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.
3. Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.
5. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

#### **NENI 19 EKSPERTËT KONTABËL**

1. Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.
3. Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

#### **NENI 20 PRISHJA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria priset:
  - a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;
  - ç) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare.

#### **NENI 21**



## LIKUIDIMI I SHOQËRISË

1. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.
2. Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
3. Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate.
4. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre. Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.
5. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.
6. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi "në likuidim".
7. Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

### NENI 22

#### TË DREJTAT E DETYRIMET E LIKUIDUESIT

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

### NENI 23

#### BILANCET E LIKUIDIMIT

1. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave.





2. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### **NENI 24 SHPËRNDARJA E AKTIVEVE**

1. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.
2. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve.
3. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

#### **NENI 25 LIKUIDIMI I THJESHTËZUAR**

1. Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedurë të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.
2. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.
3. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

#### **NENI 26 VITI FINANCIAR**

1. Në përputhje me ligjin, shoqëria do të ketë një regjistër në të cilën mbahen bilancet vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.

#### **NENI 27**

1. Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 janar të çdo viti kalendatarik dhe përfundon në 31 dhjetor të po këtij viti me përjashtim të vitit të regjistrimit ku viti financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon në 31 dhjetor.

#### **NENI 28**

1. Pas miratimit të bilancit vjetor dhe shpërndarjes së të ardhurave, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si dividendë, bazuar në kuotat që zotëron çdo ortak.

#### **PARASHIKIME PERFUNDIMTARE**



Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit të themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria ka vulen e vet në të cilën shkruhet emri i shoqërisë, numri i regjistrimit të subjektit dhe viti i themelimit.

Per ato që nuk janë parashikuar në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit.

Statuti është hartuar në tre (3) kopje origjinale me të njëjtën fuqi ligjore.

#### THEMELUES

MARIN GJONAJ

\_\_\_\_\_ 